

Komunikatë

Summit For Democracy



Organizatorët themelues të platformës **Frontline Voices in the Summit for Democracy (Zërat e vijës së parë të frontit në Samitin për Demokracinë)** mirëpresin qëllimin e Presidentit Joe Biden për t'u përfshirë në një diskutim global rreth demokracisë dhe për të eksploruar mënyra në të cilat ne mund të forcojmë kolektivisht praktikën demokratike, jetën dhe shoqëritë.

Ne e përshëndesim përkushtimin për t'na angazhuar që të punojmë në ndërtimin, forcimin dhe promovimin e vlerave demokratike në komunitetet tona, kombet dhe rajonet tona.

Në mbështetje të Samitit global për Demokracinë, organizatat tona i bëjnë thirrje qeverisë së Shteteve të Bashkuara për të siguruar që aktivistët e vijës së parë të frontit të dëgjohen ndërsa përvojat dhe aspiratat tona të pasqyrohen në mënyrë thelbësore në këtë dialog. Si përfaqësues të demokracive kombëtare dhe rajonale dhe organizatave të të drejtave të njeriut, ne besojmë se një ngjarje e rallë si kjo kërkon qasje inovative dhe një partneritet të barabartë midis përfaqësuesve të qeverive dhe organizatave joqeveritare.

Ne ftojmë komunitetin botëror të praktikuesve të demokracisë që t'u bashkohen thirrjeve dhe përpjekjeve tona për të siguruar që rezultatet e një dialogu global të kenë ndikim të qëndrueshëm në mbrojtjen dhe zgjerimin e të drejtave dhe lirive demokratike.

Në ditët në vazhdim, platforma jonë "Frontline Voices in the Summit for Democracy" do të angazhojë rrjetet tona globale të aktivistëve për të diskutuar prioritetet dhe strategjitë për të mbrojtur pjesëmarrjen e mirëfilltë dhe kuptimplote të organizatave kombëtare si partnerë në Samitin për Demokraci. Në fund të fundit, ne jemi organizatat që do të monitorojmë dhe mbajmë përgjegjësi angazhimet e qeverive tona në secilin samit.

Ne avokojmë që pika fillestare e çdo diskutimi mbi demokracinë të përqendrohet në vlerat e të drejtave themelore të njeriut. Ky diskutim duhet të përballet me pengesat dhe sulmet

ndaj të drejtave demokratike dhe të njeriut. Stabiliteti politik lind në themelet e shoqërive të bazuara në të drejta që nuk duhet të flijohen për qëllime politike.

Organizatat e nënshkruara:

Adawaa Rights

Algjeri

Qendra Al Hayat

Jordani

Lëvizja December 24th

Libi

Fondacioni për Dinjitetin Global të Njeriut

Maltë

Instituti Demokratik i Kosovës

Kosovë

Shoqata Libaneze për Zgjedhje Demokratike

Liban

Organizata Libaneze për Zhvillim

Libi

Madaniyat

Liban

Qendra Madarat për Zhvillim Komunitar

Palestinë

Mourakiboun

Tunizi

Phiren Amenca International Network

Hungari

Fondacioni Rosa Parks

Hungari

Organizata Tammuz

Irak

Qendra e Grave për Udhëzime dhe Ndërgjegjësim Ligjor

Egjipt

Historiku:

Gjatë Fushatës Presidenciale 2020 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kandidati Joe Biden paraqiti një plan të titulluar **“FUQIA E SHEMBULLIT TË AMERIKËS: PLANI I BIDEN PËR UDHËHEQJEN E BOTËS DEMOKRATIKE PËR TË TEJKALUAR SFIDAT E SHEKULLIT 21”**

Burimi: <https://joebiden.com/americanleadership/>

“Duke ndërmarrë këto hapa thelbësorë për të përforcuar themelin demokratik të vendit tonë dhe për të frymëzuar veprime tek të tjerët, Presidenti Biden do të organizojë dhe presë një Samit global për Demokraci për të ripërtërirë frymën dhe qëllimin e përbashkët të kombeve të Botës së Lirë. Gjatë vitit të tij të parë në detyrë, Presidenti Biden do të sjellë së bashku demokracitë e botës për të forcuar institucionet tona demokratike, të ndeshet me ndershmëri me sfidën e kombeve që po zmbropsen dhe të krijojë një agjendë të përbashkët për të adresuar kërcënimet ndaj vlerave tona të përbashkëta.

- Samiti do t'i japë përparësi rezultateve duke galvanizuar angazhime të reja të rëndësishme në tre fusha: (1) luftimi i korrupsionit; (2) mbrojtja kundër autoritarizmit, përfshirë sigurinë e zgjedhjeve; (3) avancimi i të drejtave të njeriut në kombet e tyre dhe jashtë saj.
- Samiti do të përfshijë organizata të shoqërisë civile nga e gjithë bota që qëndrojnë në vijat e para të frontit në mbrojtje të demokracive tona.
- Samiti do të lëshojë gjithashtu një Thirrje për Veprim për sektorin privat, përfshirë korporatat e teknologjisë dhe gjigandët e mediave sociale, për të bërë zotimet e tyre, duke njohur përgjegjësitë e tyre dhe interesin e tyre dërmues në ruajtjen e shoqërive të hapura, demokratike dhe mbrojtjen e fjalës së lirë. Për shembull, kompanitë e teknologjisë - të cilat përfitojnë nga frytet e demokracisë - duhet të bëjnë premtime konkrete për mënyrën se si mund të sigurojnë që algoritmet dhe platformat e tyre nuk po fuqizojnë shtetin e mbikëqyrjes, duke lehtësuar shtypjen në Kinë dhe gjetkë, duke përhapur urrejtje, duke nxitur njerëzit drejt dhunës dhe duke mbetur të ndjeshëm ndaj keqpërdorimit.”

Veprimi:

Më 4 maj, 2021 pesëmbëdhjetë organizata që punojnë për të drejtat e njeriut dhe të komunitetit, zhvillimin demokratik dhe zgjedhjet dhe antikorrupsionin u bashkuan së bashku për të siguruar që zërat e vijës së frontit të dëgjohen në Samitin e propozuar për Demokracinë. Pjesëmarrësit në këtë diskutim fillestar u bëjnë thirrje organizatave të tjera të përqendruara në të drejtat e njeriut dhe demokracisë që të bashkohen në platformë dhe të përfshihen në këto diskutime kritike dhe avokim. Kjo mundësi unike duhet të ketë çdo mundësi për të pasur sukses, dhe ithtarët e saj duhet të përfaqësojnë aktivizmin e rrënjëve të mirëfillta.